

Xhemile Selmani, MA¹

UDC:
005:17

**DEONTOLOGJIA DHE MENAXHIMI I MUNDËSIVE PËR
PROFESIONISTËT DHE BASJKËPUNËTORËT – SFIDAT NË
SHOQËRINË BASHKËKOHORE**

**ДЕОНТОЛОГИЈАТА И УПРАВУВАЊЕТО КАКО МОЖНОСТ
ЗА ПРОФЕСИОНАЛЦИ И СОРАБОТНИЦИ -
ПРЕДИЗВИЦИТЕ ВО СОВРЕМЕНОТО ОПШТЕСТВО**

**DEONTOLOGY AND MANAGEMENT AS OPPORTUNITY FOR
PROFESSIONALS AND COWORKERS - CHALLENGES IN
CONTEMPORARY SOCIETY**

Abstract

Deontology or ethical management constitutes one of the key components for successful behavior and serves as an opportunity for professionals and coworkers to exercise the right judgment on any challenge in contemporary society and enable a special behavior for success in their daily professional life. So, from the current viewpoint we can say with full conviction that ethics is unique science, but always we must take in consideration our viewpoint for good and evil. In the contemporary world many sciences of this nature have been presented and in this way various ethical disciplines were developed, such as the history of ethics, theoretical ethics, criminological ethics, media ethics,

¹ MSci. of Political Science, Primary School Teacher and Researcher of Comparative Political Science.

practical ethics, professional ethics, which deals with concrete duties and moral norms of various human professions such as jurists', journalists, doctors, economists and craftsmen ethics and others. But the last era is characterized by the deontology of the profession, which deals with rules of fair moral action in every activity or in each particular case of action. In everyday life we encounter a phenomenon, which is a symbol of human existence and action. This phenomenon and symbol is morality. He is a subject of special philosophical thought, practical philosophy, namely ethics.

Key words: Deontology, ethics, law, etiology, morality, practical philosophies, political thought, human action, diplomacy, ethical principles, traditionally ethics is divided into normative ethics, etc.

1. Qenësimi i vlerave etike dhe qëndrimi ndaj të mirës dhe të së keqes

Etimologjia e kësaj fjale në gjuhën shqipe do të thotë dashuri për urtësinë dhe na mëson në mënyrë kritike ta vlerësojmë situatën e dhënë, gjeqjesisht situatën e dhënë në këtë rast situatën diplomatike për veprim të drejtë dhe funksional për tërë shoqërinë bashkëkohore dhe botën diplomatike në përgjithësi në Republikën e Maqedonisë. Ndërsa gjuha filozofike etikën e përcakton si shkenca mbi moralin ose etosin.² Parimet morale mund të shikohen si standard i sjelljes që njerëzit kanë ndërtuar për veten e tyre ose si lënda e shtrëngimeve dhe detyrimeve që një shoqëri e caktuar kërkon nga pjesëtarët e saj. Ajo merret me çështjet se çfarë është e mirë dhe çfarë është e keqja, si mundemi ne të bëjmë dallimet mes tyre, a është e mira dhe e keqja e njejtë për të gjithë; si mundemi të bëjmë vendime të forta që mund të ndihmojnë apo pezmatojnë të tjerët? Emërtimi përdoret edhe për çdo sistem ose teori të vlerave morale ose parimore. Tradicionalisht etika ndahet në etikë normative, metaetikë dhe etikë e zbatuar. Po të mbështetemi në përditshmërinë filozofike për etikën do të konstatojmë se përcaktime të tilla etikën e vlerësojnë si filozofi praktike që kërkon përgjigjen e pyetjes ç' duhet të bëjmë? Etika na mundëson që në mënyrë kritike ta vlerësojmë situatën e dhënë dhe kështu ta krijojmë mundësinë për veprim praktikë të drejtë.

² Bashkim Dr. Selmani "Etika deontologjia dhe biheviorizmi" f.5-6. Universiteti parë privat "FON"-Shkup, 2010

2. Qasjet njerëzore dhe komunikimi i suksesshëm etikë

Nga kjo që thamë mund të konstatojmë se etika i mëson vlerat në jetë ndërsa sjellja morale paraqet qenësimin e vlerave etike, ndërsa etika e zgjon njeriun për njohurinë e vlerësimit. Kur flasim për Etikën na jep të kuptojmë me bindje se vendi i saj në filozofi dhe në shkencë është përcaktuar që nga Antika, që nga koha kur filozofinë e kanë ndarë në tri pjesë: Fizikën, etikën dhe dialektikën. E para hulumton botën dhe atë që është në të, Etika merret me jetën dhe të gjitha proceset që kanë të bëjnë më njerëzit: Dialektika merret me mënyrën dhe proceset e mendimeve në ato të dyja, dhe në këtë formë etika zhvillohet nëpër shumë forma dhe degë të veçanta, por gjithmonë ngel degë filozofike, sepse lënda e saj e studimit është: njeriu, vlerat e tij, qëllimet, idealet, kualitetet e të mirës dhe të keqes, por gjithmonë duke pasur si prioritet mundësinë për veprim të drejtë.

Pra, nga mendimet e deri më tanishme mund të themi me plotë bindje se etika është shkenca unike, por, gjithmonë duhet të kemi parasysh qëndrimin ndaj të mirës dhe të së keqes. Në botën bashkëkohore janë paraqitur shumë shkenca të kësaj natyre dhe në këtë mënyrë u zhvilluan edhe disiplina të ndryshme etike, siç janë historia e etikës, etika teorike, etika kriminalistike, etika mediale, etika praktike, etika profesionale e cila merret me detyra dhe norma morale konkrete të profesioneve të ndryshme njerëzore siç janë etika e juristëve, gazetarëve, mjekëve ekonomistëve zejtarëve e të tjera. Por epokën e fundit e karakterizon edhe deontologjia e profesionit e cila trajton rregulla për veprim të drejtë moral në çdo veprimtari ose në çdo rast të veçantë veprimi.³ Në jetën e përditshme hasim në një fenomen, i cili është simbol i ekzistimit dhe veprimit të njeriut. Ky fenomen dhe simbol është morali. Ai është lëndë e mendimit të veçantë filozofik, filozofisë praktike, gjegjësisht etikës. Nocioni i etikës rrjedh nga fjala greke *ethos vendlindje*, i cili në gjuhën latine do të thotë *moral zakon, shprehi, karakter; përmbledhje e vetive të përhershme që i posedon një njeri*. Krijues të nocionit *ethos* janë helenët, ndërsa të nocionit *moralis* janë latinët.

³ Për të eliminuar këtë hamendësim është e nevojshme të kihet parasysh se ekziston vetëm një etikë. Sipas Aristotelit, ajo është pjesë përbërëse e filozofisë praktike, të cilës i përkasin edhe ekonomia dhe politike. Pas Aristotelit, sinonim për etikën ose teorinë mbi moralin është filozofia praktike.

Çka e përbën esencën e ethosit ose moralisit, i cili është lëndë trajtimi jo vetëm te grekët e vjetër dhe latinët, gjegjësisht Herakliti, Sokrati, Aristoteli dhe Epikuri, por edhe shumë më vonë Spinoza, Kanti e Fichte, si edhe mendimtarët bashkëkohorë? Në mendimin grek ethosi ka të bëjë me vendbanimin, zakonin, shprehinë, sjelljen e drejtë të njeriut, institucionin, kultin e zotave, marrëveshjet miqësore, bashkësitë e luftërave, solemnitetet e ndryshme, etj. Në mësimet etike, ethosi është qenia e etikes dhe morales. Në të vërtetë, për dallim nga Platoni, Aristoteli ka konsideruar se ethosi nuk i është dhuruar njeriut nga natyra, por njeriu e fiton këtë nëpërmjet veprimit dhe zhvillimit të dispozitave të veta. Shumë më vonë, Hegeli është përpjekur të interpretojë kuptimin dhe domethënien e përkthimeve të fjalës ethos dhe është bërë kritik i rreptë i mendimit moral abstrakt dhe bashkë me mendimtarë të shumtë të filozofisë së re e ka bërë të qartë realitetin historik të zakoneve dhe etikës greke.⁴

3. Përfaqësues të këtyre interpretimeve dhe vlerat ekzistenciale

Pas Hegelit, mbi baza krejtësisht të kundërta gjegjësisht në bazë të mendimit ekzistencial, Heideggeri ka trajtuar interpretimin e nocionit ethos. Sot ekzistojnë interpretime të ndryshme mbi përmbajtjen e mësimet helen. Disa përfaqësues të këtyre interpretimeve janë të prirë të thonë se te Aristoteli parimet etike kanë më shumë karakter shoqëror se sa karakter etik. Në kundërshtim me interpretimet e ndryshme të përmbajtjes dhe kuptimit të këtij nocioni, mbizotëron mendimi që e zbulon forcën dhe madhështinë e Hegelit në kuptimin mendjemprehtë dhe kritik të ethosit dhe pikëpamjeve të tyre morale, përfshirë edhe botën e shpirtërore të tyre, duke theksuar se ethosi është i mundur vetëm ku veprohet në mënyrë të arsyeshme dhe vetëm atje ku veprohet ashtu që njeriu mund të jetë vërtet i lumtur.⁵

⁴ Në mësimet etike, ethosi është qenia e etikes dhe morales. Në të vërtetë, për dallim nga Platoni, Aristoteli ka konsideruar se ethosi nuk i është dhuruar njeriut nga natyra, por njeriu e fiton këtë nëpërmjet veprimit dhe zhvillimit të dispozitave të veta. Shumë më vonë, Hegeli është përpjekur të interpretojë kuptimin dhe domethënien e përkthimeve të fjalës ethos dhe është bërë kritik i rreptë i mendimit moral abstrakt dhe, bashkë me mendimtarë të shumtë të filozofisë së re e ka bërë të qartë realitetin historik të zakoneve dhe etikës greke.

⁵ Në mësimet etike, ethosi është qenia e etikes dhe morales. Në të vërtetë, për dallim nga Platoni, Aristoteli ka konsideruar se ethosi nuk i është dhuruar njeriut nga natyra,

Sipas këtij mendimi, ethosi ka kuptim objektiv dhe subjektiv, sepse e ka kuptimin e shprehisë, zakonit dhe moralitetit, ndërsa morali subjektiv e ka kuptimin e habitusit, ndërgjegjes, tërësinë e qenies subjektive sikur edhe tërësinë e botës në të cilën përshtatet subjekti.⁶ Mendimi i disiplinuar mbi moralin gjegjësisht etikën, në formë sistematike shfaqet me Aristotelin, ndonëse interpretimin sistematik e shkencor e kishte paralajmëruar qysh Sokrati.

Për Aristotelin, etika politika dhe ekonomia e përbëjnë filozofinë praktike. Ajo a lëndë të saj më së shumti parimet sipas të cilave me veprimin praktik përcaktohen rrugët dhe objektivat. Disa përfaqësues të mendimit bashkëkohor shtrojnë nevojën e rehabilitimit të mendimit të kritikëve të mësimëve të Platonit mbi idenë e të mirës, si parim suprem i etikës metafizike të Platonit. Ndryshe, sipas Aristotelit del se etika është teori mbi parimet e sjelljes dhe veprimit të njeriut. Mendimi i Aristotelit mbi veprimi moral dhe politik na ushtruar ndikim të fuqishëm ndër shekuj mbi atë që quhet etikë. Në fakt, Aristoteli e ka krijuar filozofinë praktike si disiplinë të pavarur e cila, me që dallon në metodë nga metafizika dhe fizika, nisat nga praktika njerëzore në themelet dhe qëllimet e së cilës, sikur edhe etika, përkufizon zakonin-traditën me të gjitha mënyrat e sjelljes së drejtë që i takon jetës shoqërore.

4. Filozofia praktike dhe pikënisje e të gjitha mendimeve të mëvonshme

Me themelimin e filozofisë së tij praktike, Aristoteli është bërë bazë dhe pikënisje e të gjitha mendimeve të mëvonshme. Se çfarë ndikimi ka teoria e tij e veprimit moral e politik tregojnë shumë shembuj, si në mendimin etik të kohës së re ashtu edhe në atë bashkëkohor. Nuk është aspak e diskutueshme se morali është objekt i filozofisë

por njeriu e fiton këtë nëpërmjet veprimit dhe zhvillimit të dispozitave të veta. Shumë më vonë, Hegeli është përpjekur të interpretojë kuptimin dhe domethënien e përkthimeve të fjalës ethos dhe është bërë kritik i rreptë i mendimit moral abstrakt dhe, bashkë me mendimtarë të shumtë të filozofisë së re e ka bërë të qartë realitetin historik të zakoneve dhe etikës greke.

⁶ Diplomacia si art i negocimit dhe komunikimit është e njohur qysh nga Antika greke. Perandoria Romake dhe ajo Osmane kishin diplomaci me konsuj, emisar etj. Në Mesjetë qytete-shtete të Italisë e zhvilluan këtë fushë veprimi. Akreditimi dhe Ambasadat. Me lindjen e komb-shteteve moderne u krijuan edhe ministritë për punë të jashtme, ku diplomacia bëhet pjesë e pandashme e tyre.

praktike ose etikës. Ai është alfa dhe omega e këtij mendimi disiplinuar. Por, problematike mbetet çështja e ndarjes së etikës. Për të eliminuar këtë hamendësim është e nevojshme të merret parasysh se ekziston vetëm një etikë. Sipas Aristotelit, ajo është pjesë përbërëse e filozofisë praktike, të cilës i përkasin edhe ekonomia dhe politike. Pas Aristotelit, sinonim për etikën ose teorinë mbi moralin është filozofia praktike. Duke pasur parasysh domethënien e filozofisë praktike të Aristotelit dhe duke pasur parasysh domethënien etike pas Aristotelit, është e tepërt të shtrohet çështja e ndarjes etike.

Por, duhet të dihet se çka nënkupton ndarja e etikës. Në qoftë se mendohet në Aristotelin, atëherë është e paarsyeshme të bëhet ndarja e saj. Por, në qoftë se merret parasysh parimi suprem i moralitetit të ndonjë mendimtari ose drejtimi të mendimit etik për ndarje, atëherë etika mund të ndahet në disa drejtime ose teori. Në bazë të këtij kriteri, teoritë, orientimet ose sistemet etike mund të ndahen në disa grupe. Grupin e parë e përbëjnë mësimet që mund të përfshijnë etikën përmbajtjesore ose teleogjike. Ato nisen nga përmbajtja ose qëllimi i veprimit njerëzor. Çdo veprim mund të jetë i mirë ose i keq, varësisht prej faktit se a do të shpie apo nuk do të shpie në realizimin e qëllimeve të njeriut. Atë e përbëjnë: hedonizmi, eudaimonizmi dhe utilitarizmi. Kjo etikë emërtohet shpesh edhe etikë e të mirave ose etikë heteronome. Të gjitha mësimet deri te Kanti konsiderohen si etikë e përmendura.

➤ Grupin e dytë të pikëpamjeve e përbën etika deontologjike ose etika e detyrës. Ajo është themeluar nga Kanti. Për dallim nga i pari, Kanti e gjen prejardhjen e parimeve morale në arsyen praktike.

➤ Grupin e tretë të pikëpamjeve e përbën etika emocionale.

Ajo shfaqet në mendimin bashkëkohor, themelues i të cilit është Max Scheler. Përveç ndarjes e teorive etike sipas botëkuptimeve të parimit suprem të moralitetit, ekziston edhe një kriter, i cili ka të bëjë me qasjen dhe qëllimin e kuptimit dhe shpjegimit të morales. Kështu, etika mund të ndahet në dy degë: teorike ose absolute dhe praktike ose normative. Kjo ndarje nuk është absolute, por relative. Etika teorike ose absolute ka për qëllim që ta kuptojë dhe ta shpjegojë moralin të tillë çfarë shfaqet jo vetëm në jetën personale të njeriut, por edhe në jetën praktike të tij, ndërsa etika praktike ose normative nuk ka për qëllim të shpjegojë botëkuptimet ekzistuese morale, por të formulojë dhe argumentojë parimet dhe rregullat në bazë të të cilave duhet të udhëhiqemi

në sjelljen dhe veprimin tonë të përditshëm.⁷ Ai mendon se etika ka detyre parësore që të hulumtojë normat morale si fakte objektive. Sipas tij, moralitetit si realitet përbëhet nga një tërësi rregullash pas të cilave qëndron ndonjë autoritet social, i cili i imponon ato, e garanton zbatimin e tyre në vepër dhe e sanksionon atë që nuk i respekton dhe nuk i zbaton.

Etika nga greqishtja *éthos*, “Karakter”, “sjellje”, “zakon” është ajo degë e filozofisë që studion fundamentet objektive e racionale që përcaktojnë sjelljet njerëzore si një “status deontico”, ose një qëndrim që di të dallojë të mirën, të drejtën, të moralshmen, nga sjelljet që përcaktohen si të këqija ose të pa moralshme. Etika mund të përcaktohet edhe si një kërkim i një ose më shumë kriterëve që i lejojnë individit përshtatjen e lirisë së tij me atë të të tjerëve. Ajo, gjithashtu kërkon një bazë racionale, jo emotive, të të sjellurit, që nuk të çojnë në përshtatje solidariste o dashurore të tipit irracional.

Në këtë mënyrë ajo vendos një kornizë të dallueshme, kufij brenda së cilës liria njerëzore mund të përhapet e të zhvillohet. Në këtë koncept të ngushtë shpeshherë konsiderohet sinonim i Filozofisë morale: në këtë këndvështrim ajo ka në thelb vlerat e moralit dhe përcaktojnë sjelljet njerëzore. Por, etika merret gjithashtu edhe me përcaktimin e asaj që mund të quhet *Kuptimshmëri*, kuptimshmëria e ekzistencës njerëzore, kuptimi i thellë i etikës-ekzistenciale të jetës si individit e të kozmosit që e rrethon.

Edhe për këtë arsye, tashmë bëhen dallime midis *etikës e moralit*. Një motiv tjetër është, se meqenëse janë përdorur shpesh si sinonime, preferohet të përdoret, fjala "moral" për të përcaktuar një bashkësi vlerash, ligje e zakone të një individit ose të një grupi të përcaktuar njerëzish, preferohet që fjala „etikë" të rezervohet për të përcaktuar thelbin racional-filozofik për të ndërtuar moralin si disiplinë. Etika mund të jetë “përshkruese” që përshkruan sjelljet njerëzore, ose normative që jep indikacione. Por, në çdo rast kërkimi bëhet mbi kuptimin e teorive të etikës. Mund të jetë subjektive, kur merret me subjektin që vepron, pavarësisht nga qëllimet, ose objektive kur veprimi është realizuar me baza e vlera të përbashkëta me institucionet. Në qendër të çdo lloj konceptimi të etikës qëndrojnë nocione si e mira, e keqja, virtyti

⁷ E. Durkheim (Dyrkem). Funkcionin normativ të etikës e kundërshton ashpër pesimisti etik Schopenhauer. Atij i kundërvihet vendosmërisht Hartmani. Tiparin e pazëvendësueshëm të moralitetit e konteston sociologu francez E. Durkheim (Dyrkem).

dhe një vizion i përcaktuar i njeriut në raporte njerëzore. Këto ide janë shpesh të lidhura me fenë, gjithsesi me një ideologji.

5. Etika apo ligje sjelljeje që pretendon që të jen të vlefshëm për të gjithë

Etika që ka në bazë fenë në fakt, përcakton ligje sjelljeje që pretendon që të jen të vlefshëm për të gjithë, ndërsa etika laike nuk mundohet që të vendos vlera të përjetshme, por tregohet e kujdesshme për sa u përket nevojave njerëzore që duhet të kenë kujdes disa kushte e transformime historike. Në të vërtetë të flasësh për një etikë laike mendohet menjëherë konfrontimi me etiken fetare, ose me një sistem vlerash dogmatike e universale të individit; në realitet është më e drejtë të flasësh për përplasje laike me problemin etik, duke përcaktuar kështu këtë përplasje si një pikë referimenti të një ideologjie e paracaktuar e vënë për të matur me problematikat e individit e të kontekstit konkret historik në të cilin shprehet.

Në jetën e përditshme hasim në një fenomen, i cili është simbol i ekzistimit dhe veprimit të njeriut. Ky fenomen dhe simbol është morali. Ai është lëndë e mendimit të veçantë filozofik, filozofisë praktike, gjegjësisht etikës. Nocioni i etikës rrjedh nga fjala greke ethos vendlindje, i cili në gjuhën latine do të thotë moral zakon, shprehi, karakter; përmbledhje e vetive të përhershme që i posedon një njeri. Krijues të nocionit ethos janë helenët, ndërsa të nocionit moralis janë latinët. Në mendimin grek ETHOSI ka të bëjë me vendbanimin, zakonin, shprehinë, sjelljen e drejtë të njeriut, institucionin, kultin e zotave, marrëveshjet miqësore, bashkësitë e luftërave, solemnitetet e ndryshme, etj. Në mësimet etike, ethosi është qenia e etikes dhe morales. Në të vërtetë, për dallim nga Platoni, Aristoteli ka konsideruar se ethosi nuk i është dhuruar njeriut nga natyra, por njeriu e fiton këtë nëpërmjet veprimit dhe zhvillimit të dispozitave të veta.

6. Kuptimi objektiv dhe subjektiv

Ethosi ka kuptim objektiv dhe subjektiv, sepse e ka kuptimin e shprehisë, zakonit dhe moralitetit, ndërsa morali subjektiv e ka kuptimin e habitusit, ndërgegjes, tërësinë e qenies subjektive sikur edhe tërësinë e botës në të cilën përshtatet subjektit. Aristoteli e ka krijuar filozofinë praktike si disiplinë të pavarur e cila, me që dallon në metodë

nga metafizika dhe fizika, niset nga praktika njerëzore në themelet dhe qëllimet e së cilës, sikur edhe etika, përkufizon zakonet-traditën me të gjitha mënyrat e sjelljes së drejtë që i takon jetës shoqërore.⁸ Kjo nënkupton një risi dhe një përparësi në raport me përpjekjet për shpjegimin shkencor të etikës. Kjo risi ka të bëjë me faktin se etika nuk merret vetëm me shpirtin e ethosit, por edhe me “prezantimin e normave objektive të vlerave”.⁹

Historia e mendimit etik ka regjistruar edhe qëndrime të diferencuara dhe të papajtueshme reciprokisht, jo aq për atë se çka është objekt i etikës dhe si të definohet, gjegjësisht jo aq për atë se çka është detyrë e saj dhe si të përcaktohet, sa përgjigja në pyetjen se cilat janë idetë e saj qendrore. Pothuaj nuk ka asnjë mësim ose drejtim etik që nuk ka shtruar pyetje të tjera prej atyre që i kanë shtruar përfaqësuesit e pikëpamjeve etikë të paraardhësve. Natyrisht, këtu mund të përmenden disa pikëpamje etike përfaqësuese mbi atë që u tha më sipër. Sipas këtyre botëkuptimeve, analiza teorike e shprehur në kuptimin e teorizimit dhe klasifikimit të vrazhdët të koncepteve nuk ka kurrfarë qëllimi vetvetiu. Dallimi, para së gjithash, ka të bëjë me pyetjen: çka është problemi etik primar. Përgjigjen në këtë pyetje e jep Kanti, nëpërmjet pyetjes: çka duhet të bëj. Ky është problemi crucial moral, i cili hyn në zonën e filozofisë praktike, gjegjësisht etikës.

Derisa objekt i mendjes së shëndoshë ka qenë njohja, veprimi moral ka qenë objekt i arsyes praktike. Derisa p.sh. në mësimin metafizik të Platonit qëndrojnë në lidhje të ngushtë idetë siç janë: Baras, Drejt dhe Bukur, të Kanti qëndrojnë E vërteta, E mira dhe E bukura. Thënë më saktë, Platoni niset prej çështjeve etike dhe politike dhe shkon drejt çështjeve mbi qenien, dijen dhe të mirën, ndërsa Kanti niset nga arsyeja

⁸ Me themelimin e filozofisë së tij praktike, Aristoteli është bërë bazë dhe pikënisje e të gjitha mendimeve të mëvonshme. Se çfarë ndikimi ka teoria e tij e veprimit moral e politik tregojnë shumë shembuj, si në mendimin etik të kohës së re ashtu edhe në atë bashkëkohor. Dëshmia më e mirë për këtë është epoka e filozofisë praktike universale e Christian Voffov-it në “Philosophia moralis” (1750), “Economica” (1754) dhe “Philosophia civilis (1756-1759) Aristoteli konsiderohet si themelues i etikës si teori mbi veprimin moral i cili nënkupton praktikën. Morali, si lëndë e etikës ose veprimi praktik të teorisë, është fenomen multipleks. Me të merren shkenca të ndryshme empirike. Pra, objekti i etikës nuk është vetëm njohuria shkencore, por edhe veprimi praktik.

⁹ Dëshmia më e mirë për këtë është epoka e filozofisë praktike universale e Christian Voffov-it në “Philosophia moralis” (1750), “Economica” (1754) dhe “Philosophia civilis (1756-1759) Aristoteli konsiderohet si themelues i etikës si teori mbi veprimin moral i cili nënkupton praktikën.

teorike dhe shkon drejt arsyes praktike, ku zbulon se ajo “duhet të”, të cilën e kupton në kuptimin moral. Përcaktimi i lëndës dhe detyrës së etikës, formuluar nëpërmjet pyetjes: “çka dhe si duhet të veprohet”, shpreh mendimin që hyn thellë në qenien dhe esencën e saj.

Pra, ajo insiston në detyrën etike në atë formë dhe përmbajtje, të cilat e ngritin mbi mekanizmin e kohës, pra kohës së matur me akrepat e orës. Forca e saj qëndron në anticipimin e asaj që është ende e parealizuar, por është e mundur objektivisht, ndonëse e penguar subjektivisht.¹⁰

Nuk ishin vetëm rrethanat e kohës që i dhanë Makiavelit një rast tepër të çmuar për të vërejtur çështjet e diplomacisë. Ai vinte nga një familje që, megjithëse në rrethana modeste, kishte qenë e rëndësishme në politikën e Fiorentinës për më shumë se dy shekuj dhe më 1498, vetëm në moshën 29 vjeçare, u caktua kancelar i dytë i republikës, edhe pse me sa duket s’kishte përvojë të mëparshme administrative.

Kancelaria e dytë merrej kryesisht me letërkëmbimin për territoret e Fiorentinës, por një muaj pas marrjes së kësaj detyre Makiaveli u bë edhe sekretar i Dhjetëshes së Luftës. Ky ishte nënkomiteti me ndikim i qeverisë fiorentine, signoria i ngarkuar me punët e saj të jashtme dhe Makiaveli erdhi në diplomaci nga shërbimi ndaj saj, vetëm katër vjet pasi pushtimi francez e kishte zhytur gadishullin në trazira. Kancelari i parë, Marçelo Adriani, ishte edhe profesor në universitet edhe “më shumë i interesuar në poezinë greke sesa në politikën italiane”. Si pasojë, Makiaveli luajti një rol më të rëndësishëm në çështjet e Dhjetëshes së Luftës sesa mund t’ia lejonte vendi i tij zyrtar.

Gjithë letërkëmbimi kalonte nga tryeza e tij dhe atij i kërkohej të shkruante shumë letra, veçanërisht udhëzime për ambasadorët. Mbas vitit 1506 ai gjithashtu ishte vërtetë ministri i mbrojtjes i republikës. Me më shumë interes për qëllimet tona, gjithsesi, është se Makiavelit i kërkohej të udhëtonte shpesh jashtë për llogari të Dhjetëshes, jo vetëm brenda Italisë, por edhe më larg si p.sh. në Francë apo Gjermani.¹¹

¹⁰ Platoni nisat prej çështjeve etike dhe politike dhe shkon drejt çështjeve mbi qenien, dijen dhe të mirën, ndërsa Kanti nisat nga arsyeja teorike dhe shkon drejt arsyes praktike, ku zbulon se ajo “duhet të”, të cilën e kupton në kuptimin moral. Përcaktimi i lëndës dhe detyrës së etikës, formuluar nëpërmjet pyetjes: “çka dhe si duhet të veprohet”, shpreh mendimin që hyn thellë në qenien dhe esencën e saj.

¹¹ Makiaveli u dërgua në misionet e rëndësishme në Romë (tetor-dhjetor 1503, gusht-tetor 1506), Francë (janar-shkurt 1504, qershor-tetor 1510) dhe Gjermani (1507-8). Ai i ndërmori misionet e tij të fundit diplomatike para shembjes së republikës së Fiorentinës në shtator 1511, kur u dërgua në Milano dhe mandej prapë në Francë edhe

Conclusion

Some ethical-deontological sciences should be included more intensively in schools even though they are foreseen with curriculum but still do not meet the criteria which are foreseen at international level and with the correct behavior toward other members in society. Human security and fair communication where ethics and deontology are involved as a common right is a key element of the rule of law, how citizens and institutional workers perceive their work and the way of living for certain vital successes. The purpose of ethics and deontology is to manage and enable professionals and coworkers to exercise their judgment, express and make a real contribution to organizational life, ethical-deontological respect in relation to the public, in view of implications, prerequisites and respective consequences, they must be applied in the manner presented to the Codex of Ethics of Favorable Behaviors today in contemporary society. This mutual action will enable equality before the law and before the Court, strengthen the care of the right of presumption of innocence, strengthen the care of the right to be tried without undue delay, strengthen the care of the right to be protected, which actually in turn include each of these elements of organizational support for institutional ethics in civic-institution relation.

Of course such a necessity will also require many efforts from ethical-deontological experiences such as behavior; ethical-legal, ethical-police, ethical-political as well as the applied practice for the opinion of the citizens on the building of the ethical infrastructure within our country, in which we express our belief that we will find cooperation and support with other national, international institutions and NGOs. Because the man himself since the beginning of his social existence felt the need to define certain rules that should be respected by all members of a community, so that common living would be more acceptable. Therefore, we remain hopeful that the scientific work aims exactly this to make common living in contemporary society more

një herë me qëllim që t'i lutej Luigjit të pezullonte thirrjen e kardinalëve frankofilë shizmatikë, që po i ndërlikonin marrëdhëniet e Fiorentinës me Romën. Makiaveli mbeti në detyrë deri më 1512, kur republika e Fiorentinës pagoi çmimin e të mosqenit në anën e palës fitimtare kur forcat spanjolle të ftuara n'Itali nga papa ia dolën t'i nxirrnin jashtë francezët. Mediciët u kthyen në qytet, republika u shpërbë e më 7 nëntor Makiaveli u pushua nga puna dhe u dërgua në mërgim të brendshëm.

acceptable in the Republic of Macedonia without inter-ethnic separation and respectable separation between communities in the democratic system of the common state.

Bibliografia dhe web-grafia

1. Bashkim Dr. Selmani „Etika deontologjia dhe biheviorizmi “Universiteti i parë privat „FON,,-Shkup 2010.
2. Caney, Simon and Peter Jones (eds.). 2001. *Human Rights and Global Diversity*. London: Frank Cass Publishers.
3. Bashkim Dr.Selmani „ *E drejta e të drejtave të njeriut,, Universiteti parë Privat „FON,,-Shkup, 2009*
4. E. B. Tylor , *Kulturë primitive* (Nju Jork: Harper Torchbooks, 1958 {1871})
5. Mark W.janis & Richard S. Kay “*E drejta Evropiane e të drejtave të njeriut,, - Shtëpia Botuese “Libri shkollor”, Prishtinë, 2002*
6. Zejnulla Gruda “Mbrotjtja ndërkombëtare e të drejtave të njeriut”, (Universiteti i Prishtinës) Prishtinë, 2001 ose botimi i katërt 2007.
7. Për një rend publik Evropian (Vendime të zgjedhura të Gjykatës Evropiane të të drejtave të njeriut, Vëllimi i I 2001, Tiranë)
8. Cassese, Antonio. 2001. *International Criminal Law. A Commentary on the Rome Statute for an Internaitonal Criminal Court*. Oxford: Oxford University Press.
9. Council of Europe (ed.). 2000 (2nd ed.). *Human Rights in Internaitonal Law*, Basic texts. Strasburg: Council of Europe Publishing.
10. Council of the European Union. 2002. *Annual Report on Human Rights*. Brussels: European Communities.
11. Bashkim Dr.Selmani “*E drejta e të drejtave të njeriut” Universiteti parë Privat „FON,,-Shkup, 2009*
12. Donnelly, Jack. 2003 (2nd ed.). *Universal Human rights in Theory and Practice*. Ithaca etc. Cornell University Press.
13. Zecchi S. “Njeriu është çfarë ai sheh!”, Sh.B. Spektër, Tiranë 2006.
14. Pango Y. “Psikologjia Sociale”, Sh.B. Korbi, Tirane 1997.
15. Dervishi Z. “Vështrime të kryqëzuara në det”, Sh.B. Jeruzalem, Tiranë 2001.